



Pranuar / Dorezuar Prilbjen / Prodato Received / Delivery	19.02	1	viti god year
Organ / Shërbim Organ / Jedince Org / Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK	733/2021		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A nr. 435/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 435/2020 të datës 24.12.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë pune Ndërtesa e Qeverisë, Kati 8, Zyra Nr.806 A, Prishtinë, kundër organit të punësimit Zyra e Kryeministrit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 19.02.2021 mori këtë;

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.435/2020 të datës 24.12.2020, e parashtruar nga

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 24.12.2020, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3288/2020 të regjistruar me numër A.nr.435/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimi Civil kundër Grupit Punues për Hartimin e Rregullores për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, i themeluar sipas Vendimit me Nr.ref.162/2020 të datës 15.06.2020, i plotësuar dhe ndryshuar me vendimin Nr.ref.135/2020 të datës 22.09.2020 dhe Vendimin Nr.ref.141/2020 të datës 30.09.2020, si dhe kundër Komisionit për Ristrukturim në Zyrën e Kryeministrit i themeluar sipas Vendimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme me Nr.Protokoll 1707 të datës 14.12.2020, me pretendimet ankimore se është shmangur dhe anashkaluar legjislacioni në fuqi, me çka është dëmtuar dhe cenuar marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunësit civil, respektivisht është shuar në mënyrë të paligjshme pozita e ankuesit respektivisht Departamenti për të Drejtën e BE-së.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.01.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Zyra e Kryeministrit.

Këshilli me datën 13.01.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë me numër protokolli 113/2020, nga Sekretariati Koordinues i Qeverisë, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 435/2020, te datës 24.12.2020, me numër protokolli 3288/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 15.06.2020, për Themelimin e Grupit Punues për Hartimin e Projekt Rregullores për Organizmin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit; Vendimin e datës 22.09.2020, për ndryshimin e Vendimit të datës 15.06.2020, Vendimin e datës 30.09.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit; Vendimin e datës 30.07.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit; Vendimin e datës 23.11.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit; Vendimin e datës 26.11.2020, të Drejtorit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë, Vendimin e datës 04.12.2020, të Drejtorit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, e-mailin e datës 11.11.2020; e-mailin e datës 15.01.2020; Rregullorjen (XX), Nr. XX/2020, për Organizmin e Brendshme dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit; e-mailin e datës 18.06.2020, të Drejtorit të Departamentit Ligjor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë; e-mailin e datës 18.06.2020, të Drejtorit të Zyrës Ligjore, në Zyrën e Kryeministrit; e-mailin e datës 19.06.2020, të Drejtorit të Departamentit në Ministrinë e Integriteteve Evropiane; Shkresë/kërkesën e datës 18.11.2020, drejtuar Zëvendës Kryeministrit; Dokument Pune i Personelit të Komisionit i datës 06.10.2020; e-mailin e datës 19.11.2020; Shkresë/Kërkesën e datës 20.11.2020, drejtuar Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Rregulloren Nr. 03/2009, për Agjencinë për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integritete Evropiane; Vendimin e datës 28.02.2020, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; E-mailin e datës 26.02.2020; Vendimin e datës 01.06.2020; Kallëzimi penal të datës 02.06.2020; Vendimin e datës 26.11.2020, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik; E-mailin e datës 27.11.2020; e-mailin e datës 30.11.2020; e-mailin e datës 01.12.2020; e-mailin e datës 26.11.2020; Njoftimin e datës 17.07.2020, të Drejtorit të DASHC; Njoftimin e datës 28.08.2020, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Njoftimin e datës 05.10.2020; Njoftimin e datës 28.08.2020, të Ministrit të Punëve të Brendshme; e-mailin e datës 07.12.2020; e-mailin e datës 07.12.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit; e-mailin e datës 30.12.2020, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik; e-mailin e datës 07.12.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Integriteteve Evropiane; Rregulloren(ZKM) Nr 01/2020, për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit; Vendimin e datës 01.07.2020; Vendimi i datës 07.10.2020, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Kërkesën e datës 23.11.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimin e datës 20.06.2019, për Themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin e datës 16.08.2019, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin e datës 01.07.2020, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Vendimin e datës 01.06.2020, të Ministrit të Ministrisë së Integriteteve Evropiane; Vendimin e datës 14.08.2020, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Vendimin e datës 07.10.2020, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Vendimin e datës 08.09.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit; Vendimin e datës 03.07.2020; E-mailin e datës 13.11.2020; E-mailin e datës 05.11.2020; Opinionin e datës 11.11.2020; Pëlqimin e datës 06.11.2020, Memorandumin Shpjegues i Rregullores për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës; Vendimin e datës 16.11.2020, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Vendimin e datës 16.11.2020, të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Rregulloren(YKM), Nr.01/2020, për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit; Vendimin e datës 04.12.2020, të

Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik; Njoftimin e datës 28.12.2020, për tërheqje nga Procedura Administrative e Propozimi i datës 31.12.2020; Përgjigje në ankesë e datës 13.01.2020, me numër protokolli 113/2020, me shkresa e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar sepse:

Bazuar në Akt Emërimin me numër protokolli 1348-1-2019 Kolegji ka konstatuar se ankuesi me datë 18.07.2019 është emëruar në pozitën e Drejtorit të Departamentit për të Drejtën e BE-se në kuadër të ish Ministrisë për Integritet Evropian.

Me Vendimin Nr.07-V-014 të datës me 03.06.2020 të Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë së Kosovës, është shuar Ministria e Integritet Evropian, ndërsa me Vendimin Nr. 11/19 të datës 01.07.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është bërë sistemimi i përkohshëm i strukturave organizative të Ministrisë së Integritet Evropian në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, tani të përfshira si pjesë e Strukturës Organizative të Zyrës së Kryeministrit sipas Rregullores ZKM Nr.01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit.

Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit me Vendimin Nr. Ref 062/2020 të datës 15.06.2020, ka themeluar Grupin Punues për Hartimin e Projekt Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.ref.135/2020 të datës 22.09.2020 dhe Vendimin Nr. Ref.141/2020 të datës 30.09.2020.

Kryeministri i Republikës së Kosovës më datë 02.11.2020 përmes kërkesës Nr.ref 239/2020, i është drejtuar Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për dhënie të pëlqimit lidhur me Draft Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit. Ndërsa me datë 06.11.2020 përmes parashtresës me Nr.914/2020 Ministri i MPB ka dhënë pëlqimin lidhur me ligjshmërinë dhe pajtueshmërinë e Draft Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit me Politikën Zhvillimore për Administratë Shtetërore, duke udhëzuar Zyrën e Kryeministrit që pas marrjes së opinionit mbi ndikimin buxhetor nga Ministria e Financave, Rregullorja në fjalë duhet të miratohet nga vet Kryeministri.

Pas marrjes së Opinionit me Nr.309 të datës 11.11.2020 të Ministrisë së Financave lidhur me vlerësimin e ndikimit buxhetor, Kryeministri i Kosovës me Vendimin Nr.251/2020 të datës 16.11.2020, ka miratuar Rregulloren ZKM Nr.01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, ku po në të njëjtën ditë Rregullorja në fjalë është publikuar edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kolegji nga shqyrtimi i Rregullores ZKM Nr.01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, ka gjetur se në këtë Rregullore nuk është përfshirë Departamenti për të Drejtën e BE-se, por në kuadër të Zyrës Ligjore është inkorporuar Divizioni për të Drejtën e BE-së.

Bazuar në kërkesën e Sekretarit të Zyrës së Kryeministrit me nr. Protokolli 3810 të datës 23.11.2020, Ministria e Punëve të Brendshme/ Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë më Vendimin me numër protokolli 1049 të datës 26.11.2020 ka themeluar Komisionin për Ristrukturim për Zyrën e

Kryeministrit, i cili Vendim është shfuqizuar me Vendimin numër protokolli 1707 të datës 04.12.2020, si dhe është themeluar Komisioni i ri për Ristrukturim me ndryshim të përbërjes së anëtarëve.

Komisioni i Ristrukturimit me datë 31.12.2020, ka përcjell Propozim Raportin e Komisionit të Ristrukturimit për Zyrën e Kryeministrit tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, i cili raport përmban shtojcën lidhur me propozimet për sistemimin e nëpunësve civil dhe rastet kur nuk aplikohet sistemimi, si dhe shtojcën me emra të nëpunësve civil të cilët duhet të sistemohen nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në institucione tjera jashtë Zyrës së Kryeministrit, e në të cilën shtojcë është përfshirë edhe ankuesi.

Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshill, lidhur me Grupin Punues për Hartimin e Draft Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, pretendon se:

- Ankuesi nuk i është komunikuar asnjëherë Vendimi Nr. Ref 062/2020 të datës 15.06.2020 për Themelimin e Grupit Punues për Hartimin e Projekt Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, si dhe ndryshimet dhe plotësimet në përbërjen e këtij grupi.
- Ankuesi në asnjë formë zyrtare apo jo zyrtare nuk është njoftuar lidhur me ecurinë e punës procedurale dhe përmbajtjesore dhe procedurën e Grupit Punues për hartimin e Projekt Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit.
- Grupi punues ka tejkalluar kompetencat ligjore sipas Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura lidhur me përgatitjen, hartimin dhe konsultimin e organizimit të brendshëm si dhe përmbajtjen e memorandumit bashkëpunues.
- Grupi Punues qëllimisht dhe pa asnjë bazë ligjore ka shuar pozitën e ankuesit me shuarjen e Departamentit të së Drejtës së BE-së, ndërsa nuk ka përkuar divizionet tjera të ish Ministrisë së Integritimit Evropian, përveç ndryshimit të emërtimeve.

Ndërsa lidhur me Komisionin për Ristrukturim ankuesi pretendon se Kryetari i Komisionit është emëruar zyrtari i kategorisë profesionale, ndërsa dy anëtarët e tjerë kanë qenë paraprakisht edhe anëtar të Grupit Punues për hartimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit dhe në këtë mënyrë pjesëmarrja e tyre në Komisionin për Ristrukturim paraqet konflikt interesi.

Organi i punësimit në përgjigjën në ankesë nga Drejtori i Zyrës Ligjore deklaroi se:

- Përmbajtja e Rregullores Nr.01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit në tërësi është në përputhje me Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura dhe Rregulloren (QRK)Nr.01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.
- Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit me kompetencë të plotë dhe në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Rregullores Nr.13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar ka themeluar Grupin Punues për përgatitjen e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit dhe po ashtu janë respektuar edhe procedurat tjera të përcaktuara me Rregulloren Nr.13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar lidhur me hartimin e akteve juridike.

- Rregullorja e kundërshtuar nga ankuesi i është nënshtruar procesit të vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Punëve të Brendshme si dhe procesit të vlerësimit të Ndikimit Buxhetor nga Ministria e Financave.
- Rregullorja Nr.01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, nuk cenon marrëdhënien e punës së nëpunësve civile përveç transferimit në një pozitë tjetër në shërbim civil.
- Ankesa e ankuesit nuk ka objekt andaj si e tillë duhet të shpallet si e pa pranueshme nga ana e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publike përkatësisht nenin 24, paragrafi 3 të këtij Ligji ku është përcaktuar se: *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji, si dhe nenin 13 të Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku parashihet se: Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik, dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se çdo nëpunës civil ka të drejtën që ta godas me mjete juridike çdo veprimi apo mosveprim, me të cilin pretendon se i janë cenuar të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës. Mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson se veprimet procedurale lidhur me themelimin e grupit punues për hartimin e Projekt Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit si dhe veprimet e grupit punues për përgatitje të kësaj Rregullore nuk kanë pasur ndonjë pasojë juridike për ankuesin në raport me të drejtat dhe interesat e tij nga marrëdhënia e punës, respektivisht në këtë fazë të procesit të përgatitjes së Rregullores së kundërshtuar nuk është ndërmarrë ndonjë veprim juridik në dëm të të drejtave të ankuesit që burojnë nga marrëdhënia e tij e punës, kështu që pretendimi ankimor mbi këtë bazë është i pa bazuar.*

Duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 44, ku përcaktohet se akt administrativ konsiderohet *çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike, dhe: 1.1. u drejtohet një ose disa personave individualisht të përcaktuar (në vijim: "akti administrativ individual", gjegjësisht "kolektiv"), apo 1.2. i drejtohet një grupi personash, të përcaktuar apo të përcaktueshëm, në bazë të karakteristikave të përgjithshme (në vijim: "akti administrativ i përgjithshëm"),* si dhe duke u bazuar në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative, Kolegji vlerëson se Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Zyrës së Kryeministrit është akt i karakterit normativ që ka të bëjë me organizimin e brendshëm dhe funksionimin e këtij institucioni dhe si rrjedhojë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka kompetencë lëndore që të vlerësoj ligjshmërinë e akteve të natyrës së tillë.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor se janë tejkalluar autorizimet e Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura përkitazi me përgatitjen, hartimin dhe konsultimin e organizimit të brendshëm si dhe përmbajtjen e Memorandumit Bashkëpunues, duke ju referuar dispozitave ligjore të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura si dhe Rregullores (QRK)Nr.01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Kolegji ka vlerësuar se është përgjegjësi ligjore e Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike që të vlerësoj

ligjshmërinë dhe pajtueshmërinë e Rregulloreve për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, konform standardeve të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, me ç'rast Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se para aprovimit të Rregullores se kontestuar Zyra e Kryeministrit ka ndjekur procedurat e lartë cekura.

Përkitazi me pretendimin ankimor se Komisioni për Ristrukturim i Zyrës së Kryeministrit, nuk ka qenë në përbërjen e kërkuar sipas dispozitave ligjore në fuqi përkatësisht se kryesuesi është zyrtar i kategorisë profesionale ndërsa anëtarët janë nga kategoria e mesme drejtuese, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe Rregulloren (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se me asnjë dispozitë ligjore nuk parshihet që anëtarët e Komisionit për Ristrukturim duhet të jenë zyrtarë të pozitave të caktuara drejtues, respektivisht me nenin 45 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është përcaktuar se "Komisioni i rristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, drejtohet nga njësi e pranimit dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në paragrafët 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të këtij neni, sipas rastit, ndërsa neni 17 paragrafi 2 i Rregullores (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ka përcaktuar se "Komisioni udhëhiqet nga njësi përgjegjëse dhe përbëhet edhe nga dy anëtarë tjerë, të cilët janë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në Nenin 54. paragrafin 2 të Ligjit, sipas rastit. Ndërlidhur me këtë Kolegji bazuar në shkresat lëndës ka konstatuar se Komisioni i Ristrukturimit sipas Vendimit numër protokollit 1707 të datës 04.12.2020 udhëhiqet nga zyrtari i DMZP ndërsa dy anëtarët tjerë janë nga institucionet e prekura me rristrukturim, respektivisht nga Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Integritimit Euvropiane. Andaj, pretendimi ankimor mbi këtë bazë është i pa bazuar.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor për shuarjen e pozitës së ankuesit, përkatësisht mos përfshirjen e Departamentit të së Drejtës së BE-së në kuadër të Strukturës Organizative të Zyrës së Kryeministrit, Kolegji bazuar në dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, ka gjetur se organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës përcaktohet varësisht nga fushëveprimi, lloji dhe kompleksiteti i detyrave dhe përgjegjësi të institucionit, me qëllim të ushtrimit të mandatit ligjor me performancë sa me efikasë dhe kosto sa me të vogël, kështu që Kolegji vlerëson se është në diskrecionin të institucionit që të përcaktoj një strukturë funksional organizative mbi parimet e lartcekura, dhe rrjedhimisht në rast rristrukturimi, nëpunësve civilë ju garantohet të drejtat e përcaktuara me dispozitat e nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A. Nr. 435/2020

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj - DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit;
- Udhëheqësit të Personelit në Zyrën e Kryeministrit; dhe
- Arkivët të KPMSHCK-së